



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 1360 Prot.

Tiranë, më 19.02.2015

UDHËZIM

Nr. 4, datë 19.02.2015

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 12.02.2015 "PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE".**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 106 dhe 107 të Kodit të Procedurave Administrative, të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 537, datë 26.09.1994 të Këshillit të Ministrave "Për shtesë mbi pagën bazë për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit",,

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e nenit 2 të Udhëzimit Nr. 2, datë 12.02.2015 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", ndryshon si vijon:

"Duke filluar nga viti 2014-2015 e në vazhdim, mësuesit që plotësojnë kriteret e pikës 2, kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit, nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnimi në vit, të cilat janë të barasvlershme me 18 orë trajnimi të pasqyruara me 1 kredit".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, IZhA, AKP, IShA, DAR/ZA, institucionet arsimore dhe agjencitë trajnuese.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

